



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMERISË INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SHKURT, 2022

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin shkurt 2022 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit shkurt 2022, zënë 19 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 96.5/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 1.6/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës, mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin shkurt 2022 në nivel kombëtar, përkatësisht 6 raste të konfirmuara me Salmonelozë jo-tifoide dhe 5 raste të konfirmuara me Shigelozë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shkurt 2022
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste shkurt 2022	Incidenca shkurt 2022 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	7	0.24
Shigelozë (Disenteri bacilare)	5	0.17
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	47	1.66
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	2673	94.4
Sëmundje diarreike në total	2732	96.5

2. Sëmundjet EPI

2.1.Fruthi

Gjatë muajit shkurt 2022 është testuar 1 rast i dyshuar me fruth nga bashkia Berat ne “Laboratorin e Virologjisë” në ISHP dhe ka rezultuar negativ. Rasti i përket grup-moshës 35-44 vjeç, është i vaksinuar me dy doza vaksine FR. Është kryer hetimi epidemiologjik i rastit nga ana e shërbimit të epidemiologjisë pranë NJVKSH-së Berat.

2.2.Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit shkurt 2022 janë raportuar 29 raste me TB pulmonar dhe ekstrapulmonar. Nga 21 rastet e raportuara me TB pulmonar, 12 janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 12 në Tiranë, 1 në Durrës, 1 në Fier, 1 në Shkodër, 1 në Dibër, 1 në Kamëz, 1 në Kukës, 1 në Lezhë, 2 në Lushnjë. Rastet ekstrapulmonare janë kryesisht pleurite dhe versamente pleurale. Gjatë muajit shkurt 2022, rastet ekstrapulmonare janë të shpërndara kryesisht në rrethet: 1 në Kamëz, 1 në Mirditë, 1 në Peqin, 4 në Tiranë dhe 1 në Tropojë. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndajra e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh, por në shtrirje rastet janë pothuasje në gjithë vendin. Bashkëpunimi me epidemiologun në rreth, me mjekun e familjes dhe pneumologun duhet të përforcohet më shumë për kontrollin e TB-së në rrethet përkatëse.

2.3 Paraliza e paspecifikuar (PFA)

Gjatë muajit shkurt 2022 NJVKSH Pogradec ka raportuar një rast suspekt PFA, nga ekzaminimi në Laboratorin e Virologjisë, ISHP. Rasti rezultoi negativ, megjithatë u krye investigimi i rastit dhe u morën masat përkatëse nga ana e NJVKSH Pogradec.

3. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2. Shpërndarja e zoonozave në muajin shkurt 2022, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks Bruceloze, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie).

	Shkurt (Raste 2022)	Incidenca (raste/100,000) 2022
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	5	0.2
Leptospirozë	0	0
TB ekstrapulmonar	8	0.28
Rikecie	2	0.07

Incidenca e Brucelozës në nivel vendi është 0.1/100.000 banore. Për muajin shkurt janë raportuar 5 raste Bruceloze, të konfirmuar 3 raste. Rikeciet 2 raste nga rrethet, Elbasan 1 rast, dhe Korçë 1 rast. Incidenca në nivel vendi rezulton 0.07raste /100.000 banorë. TB ekstrapulmonar 8 rast incidenca 0.28raste/100.000 banorë.

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shkurt 2022 janë raportuar në total 16 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.56/100.000 banorë) nga të cilat, 10 raste Hepatit viral B të konfirmuar, raportuar nga NJVKSH Tiranë, dhe 6 raste Hepatite virale as A as B të konfirmuara raportuar nga NJVKSH Tiranë.

5. HIV/AIDS

Gjatë muajit shkurt 2022 janë kryer 18 ekzaminime (12 meshkuj dhe 6 femra) për HIV prej të cilave 2 raste (2 meshkuj) kanë rezultuar HIV pozitiv. Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv janë, në Korçë dhe Tiranë. Dy rastet pozitive janë 53 dhe 55 vjeç. Rastet e dyshuara kanë ardhur kryesisht nga Banka e gjakut, ALNET, QSUT etj.

6. Sifiliz

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shkurt 2022 është raportuar 1 rast me sifiliz primar nga NJVKSH Korçë, gjinia mashkull i grup-moshës 50-54 vjeç.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI